



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Podujevë,
nr.05 - 50
13 shkurt 2019

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i datës 19.10.2017, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 20/07/2018, si dhe në kërkesat e nevojat për plotësimin e vendeve të lira të punës, për mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Podujevës, Drejtoria e Arsimit shpall:

Konkurs për mësimdhënës

1. SHFMU “ Esat Mekuli ” Dobratin
 - Një mësimdhënës për arsimin fillor
2. SHFMU “ Ilir Konushëci ” Llugë
 - Një mësimdhënës për arsimin fillor

KUSHTET:

I. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra nr. 14 e komunës),
- Certifikata e lindjes,
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje),
- Certifikatën që nuk është nën hetime
- Dëshmi mbi kualifikimin (kopja e vërtetuar),
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranohen në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve).
- **Sqarim shtesë:**
 - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente,
 - Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT,
 - Në intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas U. A. (MASHT) nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 20/07/2018,

- Intervista me kandidatë për mësimdhënës mbahet në shfmu “Dr. Ibrahim Rugova” Podujevë, sipas orarit të intervistimit i cili do të publikohet me kohë në tabelën e shpalljeve të Komunës së Podujevës (në hyrje të objektit të komunës),
 - Dokumentet nuk kthehen.
- **Afati i konkursit**
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, deri më datë 28.02.2018.

